



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)
Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400/01-1706 Dt. 12 / 05 / 2026

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika b) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-040, nenit 17 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048, nenit 7 dhe 12 të Rregullores së MF - Nr. – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve dhe neni 16 i Rregullorës për plotësim ndryshim të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve nr. 02-400/01-19798 dt.29/05/2025, Kryetari i Komunës së Drenasit merr këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Mirëqenjes e përkujdesjes Sociale, të cilat ofrojnë shërbime Sociale e Familjare të kategorive me kërkesa të veçanta.

I

1. Për implementimin e Thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF Nr. – 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat financimit publik të OJQ-ve dhe Rregullorën 12 nr.320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve dhe Rregullorën 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve.

2. Mbështetja publike për projektet/ programet e organizatave joqeveritare dhe personave fizik do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Drenasit - DSHMS, nga Kodi ekonomik për Subvencione dhe Transfere 611/73010/21200/00000/0760

II

Mjetet Financiare të ndara për Subvencione nga pika I e këtij Vendimi do të shpërndahen në bazë të Thirrjes publike për ato projekte, që pas procedurës së konkurrencës do të shpallen si fitues të përgjegjeshëm.

III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes, sipas pikës II të këtij vendimi, përfshinë:

- 1.1 Teksti i thirrjes publike
- 1.2 Udhëzimet për aplikantët
- 1.3 Formularët e aplikimit për project

2. Formularët e aplikimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1 Formularin e përshkrimit të programit ose projektit
- 2.2 Formularin e buxhetit të programit ose projektit
- 2.3 Formularin e deklaramit të mundësisë së financimit të dyfishtë të aktiviteteve nga një burim tjetër
- 2.4 Deklaratën e partneritetit (nëse është e aplikueshme)

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit / projektit
- 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
- 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit
- 3.4 Formulari muster për zbatimin e vizitave në teren F19 (nëse është e nevojshme sipas projektit)

IV

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në web faqen e Komunës së Drenasit komuna.drenas@rks-gov.net

V

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të, Komuna e Drenasit do ta themelojë Komisionin vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

VI

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit.

VII

3. Anëtarët e Komisionit vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren MF-nr.04/2017 për financimin publik të OJQ-ve dhe neni 16 i Rregullorës për plotësim ndryshim të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve nr. 02-400/01-19798 dt.29/05/2025..

VIII

1. Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve ose të personave fizik.
2. Komuna e Drenasit do të njoftojë përfituesin për kohën e nënshkrimit të kontratës.
3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjes Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IX

Ky vendim hyn në fuqi ditën e marrjes së tij nga Kryetari i komunës.


Vendimi i dërgohet:

1. DSHMS-së,
2. Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
3. Zyrë së Kryetarit,
4. Arkivë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Glllogoc)
Zyra e Kryetarit
Nr.01 400/01-17062 Dt. 12/05/2026



THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Për ofrimin e mbështetjes financiare të interesit publike për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve dhe personave fizik për fushën e Mirëqenjes e përkujdesjes sociale, të cilat ofrojnë shërbime sociale e familjare të kategorive me kërkesa të veçanta

- 1. Komuna e Drenasit u bënë thirrje publike të gjitha organizatave joqeveritare (OJQ), të regjistruara, si dhe personave fizik, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e mirëqenjes sociale, për zbatimin e projekteve dhe zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese, rehabilituese dhe ofrimin e drejtëpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare, të aplikojnë për mbështetjen financiare.**
- 2. OJQ-të dhe personat fizik në përputhje me këtë Thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për aktivitetet e mëposhtme, por duke mos u kufizuar vetëm në këtë:**
 - a. Shërbime mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë: e personave me aftësi të kufizuara;
 - b. Mbështetje për fëmijët pa kujdes prindëror ose me rrezik social
 - c. Mbështetje për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore
- 3. OJQ-ja ose individi mund të paraqesë vetëm një projekt në kuadër të aktiviteteve të lartëshenuara e që do të përfshijë dhe kontribuojë në shërbime sociale e aktivitetit të paraparë me pikën 2 të kësaj Thirrjeje publike. Numri i OJQ-ve që do të përkrahen është i kufizuar bazuar në limitet buxhetore.**
- 4. Vlera e përgjithshme e planifikuar e Thirrjes publike është 5,000.00€ (pesë mijë euro). Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 250.00 €, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 5,000.00€.**
- 5. Afati për dorëzimin e propozimit është 15 ditë pune nga dita e publikimit të Thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 12.05.2026, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit, projektit/programit është 26.05.2026, deri në ora 16:00 në qendrën për shërbime me qytetarë, në objektin e Komunës së Drenasit.**

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare të R.Kosovës, me seli në territorin e Komunës së Drenasit dhe të cilat veprojnë dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të Thirrjes publike, si dhe personat fizik banorë të Komunës së Drenasit të cilët janë të licencuar për ofrimin e shërbimeve sociale

7. OJQ-ja aplikuese duhet të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve –shërbimeve sociale, shërbime rehabilituese si dhe nëse ka qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna e Drenasit si dhe të njëjtat mjete i ka justifikuar duke paraqitur raportin financiar.

8. Lista e dokumenteve të Thirrjes Publike:

1. Formulari i projekt-propozimit F9 (plotësuar në mënyrë elektronike)
2. Formulari i propozim buxhetit F10 (plotësuar në mënyrë elektronike)
3. Formulari i deklaratës mbi financimin e dyfishtë F11 (format Word)
4. Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së
5. Çertifikata e numrit fiskal OJQ
6. Vërtetimi i Administratës Tatimore OJQ-së
7. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë (persona fizik)

Dokumentacioni i shtypur dhe ai elektronik në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur, në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i thirrjes publike, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit

9. Dokumentet obligative për përfituesit:

Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së apo Marrëveshje me ATK se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur për pagesën e kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Dëshmi se nuk është nën hetime personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit Konfirmimi nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit- OJQ-së

Licencimi për ushtrimin e veprimtarisë (shërbimet sociale/rehabilituese)

Të gjitha format e aplikimit duhet të nënshkruhen dhe të vulosen nga personi i autorizuar i aplikuesit, dhe të dorëzohet në origjinal

10. Propozimet do të dorëzohen vetëm në kuadër të formularit të paraparë, të cilin së bashku me Udhëzimet për aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të *Komunës së Drenasit- kk.rks-gov.net/drenas*. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht në zarf të mbyllur, në adresën e mëposhtme: Komuna Drenas, rrugu “Xhevë dhe Fehmi Lladrovci” 13000 - Drenas.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve pastaj vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, resurset, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasyshë.


Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci